



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2020:053300

Datë: 19.05.2020

Numri i dokumentit: 00924580

P.nr.101/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm-gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Hamzë Isufi, në çështjen penale kundër të pandehurit M.M.nga Ç. e R., Komuna e Gllogocit, për vepër penale Dhuna në familje, të parashikuar nga neni 248 par.1. lidhur me par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-Kodi i Ri, të cilin sipas autorizimit e mbronë Avokat Alban Makolli nga Prishtina, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.1460/2020, datë.06.05.2020 (e pranuar në këtë gjykatë me dt.15.05.2020), në shqyrtimin fillestar gjyqësorë publik, të mbajtur me datë 19.05.2020, në prani të Prokurorit të Shtetit Menduhi Kastrati, të dëmtuarit Sh.M., mbrojtësit të të pandehurit dhe të pandehurit, me datë.**19.05.2020**, mori dhe publikisht shpalli si dhe përpiloi këtë

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: M.M., i biri i Sh. dhe i F., e gjinisë V., i lindur me dt.... në Ç. të R., Komuna e Gllogocit, ku edhe e ka vendbanimin, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, punon kohë pas kohe në ndërtimtari, i gjendjes të dobtë ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet një procedurë tjetër për ndonjë vepër penale, gjendej në paraburgim nga data.23.04.2020.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me datën.23.04.2020, rreth orës 10:28, në fshatin Ç. të R., Komuna e Gllogocit, konkretisht në oborrin e shtëpisë së tyre familjare,i pandehuri për shkak të mosmarrëveshjeve më të dëmtuarin-babain e tij Sh.M., i njëjti ka ushtruar dhunë fizike ndaj të dëmtuarit, me qëllim të cenimit të dinjitetit të tij, në atë mënyrë që kur i dëmtuari kishte hapur dyert e oborrit për të lejuar hyrjen e kamionit me mobile për nipin e tij, i pandehuri ishte bërë nervoz, fillimisht të dëmtuarit i ka bërtitur dhe e ka ofenduar me fjalë të ndyta, pastaj e ka sulmuar fizikisht duke e goditur me grushta dore dhe e ka shtyrë në tokë dhe derisa i dëmtuari ishte i shtrirë në tokë, i njëjti ka vazhduar goditjet më shqelma dhe grushta, dhe si pasojë e këtyre veprimeve të dëmtuarit i ka shkaktuar dëmtime të lehta trupore, me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në formë të gërvishtjës dhe dërmishjës lëkurore të anës së djathtë të regjionit ballor të kokës dhe përdredhjës të indeve të buta të nyjës (kyçit, artikulacionit) të zogut të këmbës së djathtë, me besueshmëri këto dëmtime të shkaktuara nga veprimi mekanik i

mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë, i topitur), si dhe ndjenjën e frikës, ankthit dhe të pasigurisë për jetë,-

- më këtë ka kryer veprë penale Dhunë në familje, të parashikuar nga neni 248 par.1. lidhur me par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-Kodi i Ri.

Andaj gjykata në vështrim të neneve 4,7,17,21,38,42,43,69,79 dhe nenit 248 par.1, lidhur me par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-Kodi i Ri si dhe neneve 360,361, 365,450 par.3. dhe 453 par.2. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i shqiptonë:

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit M.M.në shumë prej 400 (katërqindë) Euro, të cilin detyrohet të e paguaj në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri në afatin e caktuar nuk dëshironë ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgë. Kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së.

Nëse i pandehuri në afatin e caktuar nuk dëshironë ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do të zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siq parashihet në paragrafin 3 të nenit 43 të KPRK-së. E nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të pandehurit, në vend të shqiptimit të dënimit me burgë, të e zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzetë (20) Euro gjobë, kjo mundësi e tillë e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.5. të KPRK-së, **si dhe**

DËNIM ME BURGË

Të pandehurios **M.M.NË KOHËZGJATJE PREJ 6 (gjashtë) MUAJ**, të cilin do të e vuaj 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ndaj të pandehurit është hequr masa e paraburgimit, pasi që kanë pushuar shkaqet e caktimit të paraburgimit dhe i njëjti menjëherë është liruar nga paraburgimi nga Qendra e Paraburgimit në Prishtinë-Hajvali me dt.19.maj.2020 dhe mbrohet në liri, për çka gjykata ka marrë aktvendim të veçantë.

Koha e kaluar në paraburgim në kohëzgjatje prej 27 (njëzetëeshtatë) ditë, dhe atë prej dt.23.04.2020 e deri me dt.19.05.2020, të pandehurit do të i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgë.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej **20 Euro**, si dhe në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej **50 Euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Detyrohet i pandehuri që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej **30 Euro**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari Sh.(D.) M. nga Ç. e R., Komuna e Glllogocit, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike lidhur me kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Pergjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.1460/2020, datë.06.05.2020 (e pranuar në këtë gjykatë me dt.15.05.2020), ka akuzuar të pandehurin për vepër penale Dhuna në familje, të parashikuar nga neni 248 par.1. lidhur me par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-Kodi i Ri.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.19.05.2020, ku ka ftuar Prokurorin e Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Pergjithshëm Menduhi Kastrati, të pandehurin (i sjellur sipas urdhëresës nga Qendra e Paraburgimit në Prishtinë-Hajvali) dhe mbrojtësin e tij sipas autorizimit Avokat Alban Makolli, ashtu siq e parashehë neni 245 par.1. të KPP-së.I pranishëm ishte edhe i dëmtuari Sh.M..

Në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtën e tij, ashtu siq e parashehë neni 246 par.1. të KPP-së.I pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar udhëzimet.

Gjyqtari ka çmuar se e drejta e të pandehurit në mbrojtës është respektuar dhe se Prokurori i Shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë në zbulimin e provave nga neni 244 të këtij Kodi, ashtu siq e parashehë neni 246 par.2. të KPP-së.

Në bazë të nenit 246 par.3.të KPP-së, Prokurori i Shtetit ka lexuar aktakuzën.I pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën.Në bazë të nenit 246 par.4. të KPP-së, pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të pandehurit i ka ofruar mundësinë të pranoi fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi në të gjitha pikat e aktakuzës, pastaj gjyqtari ka përcaktuar se: i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, se pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri dhe pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, të gjitha këto të parapara me nenin 248 par.1. të KPP-së.

Në bazë të nenit 248 par.2. të KPP-së, për vlerësimin e pranimi të fajësisë së të pandehurit, gjyqtari ka kërkuar mendimin e Prokurorit të Shtetit, mbrojtësit të të pandehurit dhe të dëmtuarit.Të njëjtit deklaruan se janë përmbushur kushtet nga neni 248 par.1. të të njëjtit Kod.

Në bazë të nenit 248 par.4. të KPP-së,pasi që gjyqtari u bind se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1. i këtij neni, mori aktvendim me të cilin e pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe dhe vazhdoi me seancën për vërtetimin e fakteve relevante për shqiptimin e dënimit,para shpalljes së vendimit mbi dënimin.

Në shqyrtimin për vërtetimin e fakteve relevante për shqiptimin e dënimit, gjykata ndëgjoi palët, ku:

Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Pergjithshëm lidhur me vërtetimin e fakteve relevante për shqiptimin e dënimit deklaroi: me qenë se i pandehuri e pranoi fajësinë, për vepër penale për të cilën është akuzuar, e poashtu aktakuza mbështetet me prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se është kryer vepra penale, i propozojmë gjykatës që të njëjtin të e shpall fajtor dhe të e dënoi sipas ligjit, për vepër penale për të cilën e pranoi fajësinë, e poashtu të vlerësoi të gjitha rrethanat, të cilat ndikojnë në matjën e dënimit, qofshin ato lehtësuese, si pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte dhe pendimin për veprën penale për të cilën e ka kryer, ndërsa rrethanë rënduese të e marrë për bazë, sepse vepra penale është kryer ndaj babait të tij dhe faktin se veprat penale Dhunë në familje kohën e fundit kanë marrë hovë në shoqërinë tonë.

I dëmtuari, lidhur me vërtetimin e fakteve relevante për shqiptimin e dënimit deklaroi se: nuk jam që djali im të dënohet, kërkoj kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale dhe kam dhimbje në kokë, kembë, kam marramendje, nuk di të orientohem kah të eci

edhe nuk kam gjumë. E kam përjetuar rëndë këtë rast që më ka ndodhur me djalin tim. Kurrë rahat s'më ka lenë, deri kësaj radhe më ka sulmuar fizikisht, vetëm se gjithnjë më ka ushtruar dhunë psikike.

Mbrojtësi i të pandehurit, lidhur me vërtetimin e fakteve relevante për shqiptimin e dënimit deklaroi: i propozoi gjykatës të e aprovoi pranimin e fajësisë dhe rrethanat lehtësuese, të cilat i propozoi Prokurori, e rrethanë veçanerisht lehtësuese të e merrë faktin, se i pandehuri është mbajtës i familjës, sepse kujdesët për motrën e tij, e cila është e prekur nga sindromi doën, andaj i propozoi gjykatës që të pandehurit të i shqiptoi sanksion penal sa më të butë, për mes të cilit nuk do të mundë të pengohet i pandehuri nga mbikqyrja dhe përkujdesi për motrën e tij.

I pandehuri, lidhur me vërtetimin e fakteve relevante për shqiptimin e dënimit deklaroi: e mbështesë në tërësi fjalën e mbrojtësit tim, e kam pranuar fajësinë, i premtoi gjykatës se në të ardhmën nuk do të përsërisë veprën e njejtë, e ndiej vetën shumë keq, sepse nuk është dashur të e godasë babain. Më vjen marre për këtë veprim që kam berë, e të cilin nuk e përsëriti. Kam informacione se babai nuk jeton më me mua në një shtëpi, për shkak të rasti që kam berë unë. I kërkoi falje babait për veprimet që i kam berë përkatësisht që e kam sulmuar. I dëmtuari deklaroi se: e pranoi kërkim faljen e tij me kusht që ai të e mbajë fjalën e dhenë.

Duke i vlersuar me ndergjegje provat e nxjerrura në procedurë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, në baze të nenit 7 par.1. dhe nenit 361 të KPP-së, gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjendjen e këtillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe nga provat dhe faktet që i përmbanë aktakuza.

Nisur nga këto fakte dhe prova të vërtetuara në procedurë, në veprimet e të pandehurit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të lartëtheksuar, të cilën e ka kryer me dashje direkte, me çka e ka dëshiruar kryerjen e kësaj vepre penale.

I pandehuri e ka kryer këtë vepër penale, sepse në bazë të nenit 7 të KPRK-së, kjo vepër penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparët e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Për këtë vepër penale është shpallur fajtor, sepse në përputhje me nenin 17 par.1. të KPRK-së thuhet se "kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia". Në rastin konkret i pandehuri këtë vepër penale e ka kryer me dashje direkte sipas nenit 21 par.2. të KPRK-së, ku është paraparë sanksioni penal.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të pandehurin pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të pandehurin merr faktin se e ka pranuar fajësinë në tërësi, premtimin se në të ardhmën nuk do të kryej vepra të tilla apo të tjera penale, se është penduar për veprën e kryer penale dhe shprehjen e kërkim faljës, ndërsa rrethana rënduese gjeti se kemi shkallë të lartë të dashjës nga ana e të pandehurit gjatë kryerjes së veprës penale, se shkalla e dëmit të i dëmtuari është e lartë dhe se i dëmtuari është i moshuar, i moshës 73 vjeçare-viktimë e ndjeshme, andaj edhe pse për këtë vepër penale është i paraparë dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim deri në tre vite, të njëjtit ia shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 400 (katërqindë) Euro dhe dënimin me burgë në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, me bindjen se dënimi me gjobë dhe dënimi me burgë është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit, më bindje se të njëjtat dënime do të ndikojnë që të parandalojnë të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmën dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarit për dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e

detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Ndaj të pandehurit është hequr masa e paraburgimit, pasi që kanë pushuar shkaqet e caktimit të paraburgimit dhe i njëjti menjëherë është liruar nga paraburgimi nga Qendra e Paraburgimit në Prishtinë-Hajvali me dt.19.maj.2020 dhe mbrohet në liri, për çka gjykata ka marrë aktvendim të veçantë në bazë të nenit 367 par.1. nënpar.1.2. të KPP-së.

Vendimin që koha e kaluar në paraburgim në kohëzgjatje prej 27 (njëzetëeshtatë) ditë, dhe atë prej dt.23.04.2020 e deri me dt.19.05.2020, të pandehurit të i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgë, gjykata e bazoi në nenin 79 par.1. të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e bazoi në nenin 451 par.1., nenit 453 par.1. lidhur me nenin 450 par.2. nënpar.2.1. të KPP-së, ashtu që e detyroi të pandehurin që të paguajë gjithsejtë shumën prej 20 € euro në emër të shpenzimeve të ekspertit të mjekësisë ligjore.

Vendimin që i pandehuri të paguaj në emër të paushallit gjyqësorë shumën prej 50 € euro, gjykata e bazoi në nenin 450 par.2.6. dhe par.3. të KPP-së, duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmerinë e procedurës dhe gjendjen financiare të të pandehurit.

Vendimin që të detyrohet i pandehuri që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej 30 € euro, gjykata e bazoi në nenin 39 par.3. nënpar.3.1. të Ligjit nr.05/L-036 për Kompenzimin e Viktimave të Krimit (ku është paraparë se gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuar në nënparagrafët 3.1. dhe 3.2. të këtij paragrafi caktojnë edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim: për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në shumë prej tredhjetë (30) €), i cili ligj me datën.28.05.2015 ka hyrë në fuqi, e për të cilin Gjykata Supreme e Kosovës me Qarkoren nr.35/2018, të dt.30.01.2018, për zbatimin e të Ligjit nr.05/L-036 për Kompenzimin e Viktimave të Krimit ka kërkuar nga gjykatat që të zbatojnë këtë dispozitë ligjore për të e paguar taksën e lartëtheksuar.

Vendimin që të dëmtuarin Sh.(D.)M. nga Ç. e R., Komuna e Glllogocit, lidhur me realizimin e kërkesës pasuroro juridike për kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale, të e udhëzoi në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 463 par.2. të KPP-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërisht të kësaj kërkesë.

Nga e lartëtheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLLOGOC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.101/2020, datë:19.05.2020

Procesmbajtësi
Hamzë Isufi

G j y q t a r i
Shefqet Baleci

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Në bazë të nenit 380 par.2. të KPP-së, ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar si më lartë, e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit.